

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

**Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Përfaqësimi Ligjor Jo-efektiv**

**Edicioni 7**

**Shtator 2010**

## Përmbledhje Ekzekutive

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) është e shqetësuar lidhur me përfaqësimin ligjor jo-efektiv të vërejtur në procedurat penale dhe civile në Kosovë. Përfaqësimi ligjor nga avokatët mbrojtës në çështje penale, dhe nga avokatët kur janë të autorizuar si përfaqësues në çështjet civile, shpesh është nën standarde dhe jo-efektiv. Kjo mund të shkel kornizën ligjore në Kosovë, Kodin e Etikës Profesionale të Avokatëve,<sup>1</sup> dhe ligjin ndërkombëtar. Po ashtu ka pasoja serioze në të drejtën e të pandehurit për gjykim korrekt.

### Procedurat Penale Kryerja e Detyrave të Avokatëve Mbrojtës

Nga avokati mbrojtës pritet që të luajë rol aktiv në procedurat penale. Sipas Ligjit mbi Procedurën Penale të Kosovës,<sup>2</sup> avokati mbrojtës do të caktohet mbi baza të shpenzimeve publike në qoftë se kjo është në interes të drejtësisë dhe nëse i pandehuri nuk ka mundësi ta paguaj.<sup>3</sup> Ligji nuk vendos detyrime të ndara të avokatit bazuar në atë nëse avokati është angazhuar sipas detyrës zyrtare apo privatisht. Detyrat e avokatit mbesin të njëjta.

Ngjashëm, Neni 6 (3)(c) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ), i jap personit të drejtën “për ta mbrojtur veten personalisht apo përmes ndihmës ligjore të zgjedhur vet ose, po që se nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar ndihmën ligjore, kjo t’i jepet falas kur interesat e drejtësisë kërkojnë një gjë e tillë.” Siç sqarohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), KEDNJ ka për qëllim të garantojë të drejtat që janë “praktike dhe efektive” e jo “teorike apo iluzore”,<sup>4</sup> që nënkupton se autoritetet kanë obligim të sigurojnë se ndihma ligjore është efektive, veçanërisht kur caktohet nga gjykata.

Përderisa disa avokatë mbrojtës ofrojnë përfaqësim ligjor efektiv, ka shumë shembuj kur si avokatët e caktuar sipas detyrës zyrtare ashtu dhe ata të angazhuar privatisht dështojnë të ushtrojnë detyrat e tyre profesionale të avokatit.

OSBE kanë qenë dëshmitare në një numër shembujsh që ngritën shqetësime lidhur me përfaqësim jo-efektiv ligjor. Në disa raste avokatët mbrojtës ishin parë në përgjithësi si pasiv dhe të pa-interesuar, aty vetëm për të përmbushur kushtin se përfaqësimi ligjor ishte

---

<sup>1</sup> Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit, Oda e Avokatëve të Kosovës, 7 korrik 2007 (prej këtu e tutje “Kodi i Etikës Profesionale”). E qasur me 4 gusht 2010 nga [http://oak-ks.org/images/dokumente/oak\\_dok.kodi-shqip.pdf](http://oak-ks.org/images/dokumente/oak_dok.kodi-shqip.pdf)

<sup>2</sup> Fillimisht i quajtur Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, që ishte shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet dhe plotësimet pasuese. Me 22 dhjetor 2008, ishte shpallur Ligji Nr. 03/L-003 mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës Nr. 2003/26, i cili la ligjin përmbajtësisht të njëjtë me ligjin e vitit 2003, megjithëse një seksion për deklarimin e fajësisë ishte shtuar, një nen për kohëzgjatjen e paraburgimit policor ishte plotësuar, dhe emri i ligjit ishte ndërruar në Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, prej këtu e tutje i referuar si KPPK.

<sup>3</sup> Nenet 12(4), 73 dhe 74(1)(2), KPPK.

<sup>4</sup> GjEDNJ, *Artico kundër Italisë*, 6694/74, 13 maj 1980, paragrafi 33.

i pranishëm, dhe në përgjithësi dështuan të shfrytëzojnë garancitë procedurale të projektuara për mbrojtjen e të drejtave të klientëve të tyre. Raportet e mëparshme të OSBE-së trajtuan këto çështje përmes një numri të shembujve.<sup>5</sup> Ky raport vazhdon t'i trajtojë ato.

Me 29 prill 2010, në një seancë konfirmimi pranë një gjykate të qarkut, i pandehuri i tha gjyqtarit se avokati mbrojtës nuk e kishte vizituar derisa ndodhej në paraburgim. Periudha e paraburgimit kishte filluar katër muaj më herët, pas arrestimit të tij me 28 dhjetor 2009, pa vizita nga avokati i tij mbrojtës. Avokati mbrojtës nuk e kundërshtoi klientin e vet. I pandehuri u deklarua fajtor pasi që gjyqtari lexoi aktakuzën. Për shkak se i pandehuri po shfaqte probleme të shëndetit mendor, gjyqtari, para se ta pranojë çfarëdo deklarimi të fajësisë, kërkoi që i pandehuri së pari t'i nënshtrohet një ekzaminimi psikiatrik. I pandehuri nuk përfitoi nga ndonjë argument i avokatit mbrojtës që ai mund të mos mbajë përgjegjësi penale për shkak të sëmundjes mendore. Deri në gusht të vitit 2010 gjykata ende nuk ka pranuar vlerësim të ekzaminimit psikiatrik dhe seanca e radhës gjyqësore nuk pritet të mbahet deri në shtator 2010. I pandehuri vazhdon të qëndrojë në paraburgim.

Si korniza ligjore e Kosovës ashtu edhe ligji ndërkombëtar parashohin që i akuzuari të ketë të drejtën e kohës së mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.<sup>6</sup> OSBE ka monitoruar shkeljen e kësaj të drejte, shpesh për shkak të dështimit të avokatit mbrojtës për të kërkuar kohë për përgatitje. Veç kësaj duhet të përmendet se menaxhimi i dobët i rasteve nga ana e gjykatave ndikon negativisht në kryerjen e punës së avokatëve duke e bërë të vështirë për ata që të planifikojnë orarin e punës apo të zhvillojnë një strategji mbrojtëse. Avokatët mbrojtës janë ndërruar shpesh herë në shumë raste të monitoruara nga OSBE.

Me 17 shkurt 2009, gjatë një seance për konfirmim pranë një gjykate të qarkut, i pandehuri kishte dhënë deklaratë me të cilën pohonte se kishte vepruar në gjendje të shqetësimit mendor, për shkak të neglizhencës ose në vet-mbrojtje lidhur me një akuzë për vrasje në tentativë. Avokati mbrojtës propozoi që aktakuza të tërhiqet por nuk sqaroi pse. Me 16 shkurt 2010 ka pasur ndërrim të avokatit mbrojtës posa kishte filluar gjykimi. Avokati i ri mbrojtës ktheu kokën nga të pandehurit e shumë për të kuptuar se cili ishte klienti i vet, dhe më pas dështoi të ofroi mbrojtje. Kjo sugjeron se avokati i ri nuk ka pasur komunikim me klientin e vet para gjykimit, andaj nuk ka mundur të përgatitet në mënyrë të duhur. I pandehuri u deklarua fajtor dhe u dënua me dy vite e gjashtë muaj burgim.

<sup>5</sup> Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale (*1 shkurt 2000 – 31 korrik 2000*) E qasur me 4 gusht 2010 nga [http://www.osce.org/documents/mik/2000/08/970\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2000/08/970_sq.pdf); Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale (*tetor 2001*), faqet 28-31. E qasur me 4 gusht 2010 nga [http://www.osce.org/documents/mik/2001/11/966\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2001/11/966_sq.pdf); Shqyrtimi i OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale (*prill 2003 – tetor 2004*), 73-78. E qasur me 4 gusht 2010 nga [http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2004/12/3984_sq.pdf); Raport Mujor i OSBE-së *janar 2009*. E qasur me 4 gusht 2010 nga [http://www.osce.org/documents/mik/2009/01/39174\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2009/01/39174_sq.pdf).

<sup>6</sup> Neni 12, KPPK, Neni 6(3)(b), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, Neni 14(2)(b), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

I pandehuri mund të përfitojë nga ndërrimi i avokatit në rast kur avokatët jo-efektiv zëvendësohen nga avokatë të kualifikuar. Avokatët shpesh ishin të pranishëm për të përmbushur kushtin e pranisë së mbrojtjes, pa qenë gjykata e shqetësuar lidhur me efikasitetin e përfaqësimit ligjor. Gjykatat janë të obliguara që ta njohin dhe ta respektojnë rolin kritik të avokatit mbrojtës për të siguruar që i pandehuri të ketë gjykim të drejtë. “Është aspekt thelbësor i të drejtës për gjykim korrekt që procedurat penale[...] duhet të zhvillohen bazuar në parimin e kontradiktoritetit dhe se duhet të ketë barazi të armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes.”<sup>7</sup> Pabarazia e palëve para gjykatës mund të rezultojë në dështim të drejtësisë. Kur avokati mbrojtës dështon të ofrojë përfaqësim efektiv, autoritetet duhet ose ta ndërrojnë avokatin ose përndryshe ta detyrojnë avokatin t’i përmbush obligimet e domosdoshme.<sup>8</sup>

### **Procedurat Civile Kryerja e Detyrave nga Përfaqësuesit e Autorizuar Ligjor**

OSBE është e shqetësuar se dështimi i përfaqësuesve të autorizuar në rastet civile për të përfaqësuar denjësisht dhe në mënyrë efektive interesat e klientëve të tyre, mund të shkel kornizën ligjore në Kosovë, Kodin e Etikës Profesionale dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ligji i aplikuar mbi Procedurën Kontestimore<sup>9</sup> (LPK) parasheh se pala gjyqësore mund ta zhvillojë procedurën ose personalisht ose përmes përfaqësuesit të autorizuar. Pala, gjatë rrjedhës së procedurës mund ta caktojë një përfaqësues të autorizuar ose gojarisht, ose me shkrim.<sup>10</sup> Pala përcakton shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit, mund ta autorizojë përfaqësuesin që të ndërmerr vetëm “disa veprime të caktuara ose të gjitha veprimet në një procedurë”.<sup>11</sup> Veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi kanë të njëjtin efekt ligjor si veprimet e ndërmarra nga vet pala.<sup>12</sup> Megjithatë, pala mund ta tërheq apo ndryshojë deklaratën e dhënë nga përfaqësuesi i autorizuar.<sup>13</sup> Përderisa fokusi i këtij raporti është në përfaqësuesit e autorizuar që janë avokatë, nuk është e domosdoshme që përfaqësuesi i autorizuar të jetë avokat. Cilido person që ka zotësi të plotë ligjore për të vepruar mund të

<sup>7</sup> GjEDNJ, *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27053/95, 16 shkurt 2000, paragrafi 51.

<sup>8</sup> GjEDNJ, *Kamasinski kundër Austrisë*, 9783/82, Aktgjykim, 19 dhjetor 1989, paragrafi 65; Neni 75(4) KPPK.

<sup>9</sup> Ligji Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008, të cilin gjykatat kanë filluar ta zbatojnë me 6 tetor 2008. Shih po ashtu Gazetën Zyrtare të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë 4/1977, 36/1980 dhe 66/1982 të 12 shkurtit 1982 me amendamentet e vitit 1998 (ligji mbi procedurën kontestimore i vitit 1982). Shumë dispozita të LPK-së mbesin përmbajtësisht të njëjta me ato të ligjit mbi procedurën kontestimore të vitit 1982.

<sup>10</sup> Nenet 85.1, 92.1, LPK. Kur autorizimi jepet gojarisht kjo duhet të evidentohet në procesverbal të gjykatës.

<sup>11</sup> Nenet 89 deri në 91, LPK

<sup>12</sup> Neni 86.2, LPK. Neni 87 parasheh se pala “Pala mund ta ndryshojë ose ta revokojë deklaratën e përfaqësuesit në seancën në të cilën është dhënë deklarata e tillë” dhe gjithashtu parasheh që nëse përfaqësuesi “e ka pohuar ndonjë fakt në seancë në të cilën nuk ka qenë e pranishme pala, apo në qoftë se ai e ka pohuar ndonjë fakt me anë të parashtrësës, kurse pala me vonë e ndryshon apo revokon pohimin e tillë, gjykata i vlerëson të dy deklaratat në pajtim me këtë ligj.”

<sup>13</sup> Nenet 86.2 dhe 87, LPK

kualifikohet.<sup>14</sup> Nëse një gjykatë gjen se përfaqësuesi i autorizuar nuk vepron në pajtim me Ligjin e aplikuar mbi Avokatinë,<sup>15</sup> gjykata është e obliguar ta njoftojë “odën kompetente të avokatëve.”<sup>16</sup>

Përfaqësuesi i autorizuar është i obliguar “t’i përmbahet ligjit dhe së drejtës si dhe të sillet në pajtim me etikën e nderit të profesionit gjatë ushtrimit të profesionit.”<sup>17</sup> Avokati “nuk duhet t’i shkaktojë klientit shpenzime të panevojshme”, duhet ta përfaqësoj klientin “me ndërgjegje dhe me zell” dhe ta njoftojë rregullisht klientin në lidhje me zhvillimet e lëndës.<sup>18</sup> Është detyrim që t’i ofrojë “mbrojtje te nevojshme juridike [klientit] sa më shpejtë që është e mundur “ dhe të ndërmerr masa për të parandaluar çfarëdo vonese ose çfarëdo “keqpërdorim të drejtave para gjykatave dhe organeve tjera.”<sup>19</sup> Avokati nuk duhet t’i jep gjykatës “ndonjë informatë të rrejshme “ ose çfarëdo informate “të natyrës së tillë që ta shtyjë të gabojë” për të bërë gabim gjatë gjykimit të rastit.<sup>20</sup> Gjykata është e autorizuar të shqiptojë dënim me gjobë monetare ose masa tjera ligjore kur përfaqësuesi ligjor shkel obligimet profesionale.<sup>21</sup>

Veç kësaj, Neni 6(1) i KEDNJ-së parasheh se “çdokush ka të drejtën për dëgjim të drejtë dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.”<sup>22</sup> Gjykata ka gjetur se ky kusht “shpreh rëndësinë e ndarjes së drejtësisë pa vonesa që do të mund të dëmtonin efikasitetin dhe besueshmërinë e saj.”<sup>23</sup> Të gjitha procedurat e mbuluara nga Neni 6 (1) i parashtrihen kushtit për kohë të arsyeshme.<sup>24</sup> Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës do të vlerësohet në kuptim të rrethanave të veçanta të rastit [...], duke marr parasysh ndërlíkueshmërinë e rastit dhe sjelljen si të parashtruesit të kërkesës ashtu edhe të autoriteteve kompetente.<sup>25</sup>

Përfaqësuesi i autorizuar po ashtu duhet të merr parasysh domosdoshmërinë për gjykim të drejtë në kuptim të Nenit 6(1) të KEDNJ-së. Kur përfaqësuesit e autorizuar dështojnë t’i kryejnë detyrat e veta me zell dhe në mënyrë efektive, vonesat shpesh e vënë në rrezik të drejtën e palës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

---

<sup>14</sup> Neni 86.1, LPK.

<sup>15</sup> Ligji Nr. 03/L-117 mbi Ligjin mbi Avokatinë, Gazeta Zyrtare e Kosovës 49, 25 mars 2009. Ky ligj mbizotëron Ligjin mbi Avokatinë dhe Asistencë tjetër Ligjore, Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr:011-69/79.

<sup>16</sup> Neni 88.2, LPK.

<sup>17</sup> Neni 11, Ligji mbi Avokatinë.

<sup>18</sup> Neni 30, Kodi i Etikës Profesionale.

<sup>19</sup> Neni 49, Kodi i Etikës Profesionale.

<sup>20</sup> Neni 50, Kodi i Etikës Profesionale.

<sup>21</sup> Nenet 288-295, LPK, për veprimtarinë e përfaqësuesve ligjor që përmban “mosrespektim të gjykatës”.

<sup>22</sup> Neni 6 (1), KEDNJ.

<sup>23</sup> GjEDNJ, *H. kundër Francës*, 24 tetor 1989, paragrafi 58.

<sup>24</sup> GjEDNJ, *König kundër Gjermanisë*, 28 korrik 1978, paragrafi 96.

<sup>25</sup> GjEDNJ, *H. kundër Francës*, 24 tetor 1989, paragrafi 50; shih po ashtu *König kundër Gjermanisë*, 28 korrik 1978, dhe *Pedersen dhe Baadsgaard kundër Danimarkës*, 17 dhjetor 2004.

OSBE ka monitoruar raste civile kur përfaqësuesit e autorizuar ishin neglizhent për të përfaqësuar palët në mënyrë efektive dhe të zellshme, duke dëmtuar palën dhe duke shtuar jo-efikasitetin e gjykatës.

Me 19 nëntor 2009, palët parashtuan një propozim të përbashkët pranë një gjykate të qarkut, me të cilin kërkonin shpërbërjen e martesës së tyre. Gjatë një dëgjimi më 9 dhjetor 2009, bashkëshortja ishte e pranishme së bashku me një përfaqësues të autorizuar i cili përfaqësonte të dyja palët, bashkëshorten dhe bashkëshortin. Bashkëshortja dhe përfaqësuesi i autorizuar konfirmuan marrëveshjen e përbashkët për shpërbërje të martesës. Gjatë rrjedhës së seancës dëgjimore u ngritën disa mospërputhje lidhur me fakte të rëndësishme të prezantuara në dokumentet e gjykatës, përfshirë numrin e fëmijëve nga martesa dhe vendbanimin e saktë të bashkëshortit. Përfaqësuesi i autorizuar nuk i kishte kushtuar vëmendje të mjaftueshme rastit. Gjykata kërkoi që Qendra për Punë Sociale të zhvillojë një procedurë paraprake pajtimi dhe të ofrojë mendimin e vet lidhur me kujdestarinë e fëmijëve të mitur. Rasti ishte caktuar të vazhdojë me 21 prill 2010. Në atë ditë kur seanca u mbledh, asnjëra palë, e as përfaqësuesi i autorizuar i tyre nuk ndodheshin në gjykatë. Pas konstatimit se të gjithë ishin ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungonin pa dhënë arsyetim, gjykata hodhi poshtë propozimin për shkurorëzim. Bashkëshorti dhe bashkëshortja hynë në sallën e gjykimit disa minuta më vonë. Ata sqaruan se kishin pritur që përfaqësuesi i tyre i autorizuar të jetë i pranishëm dhe kërkuan nga gjyqtari që ta rihap procedurën. Kërkesa ishte refuzuar.

Përkundër obligimit për të promovuar interesat e klientëve të tij dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre, ky përfaqësues i autorizuar dështoi në kryerjen e detyrave të tij me zellin dhe profesionalizmin e kërkuar dhe kjo ndikoi negativisht në klientët e tij. Kur përfaqësuesit e autorizuar dështojnë t'i kryejnë detyrat e tyre me zell apo profesionalisht, gjykata mund të jetë e obliguar të intervenojë. Gjykata ka "për detyrë të përpiket që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale"<sup>26</sup> që u takojnë palëve. Në këtë rast gjykata është dashur që t'ia rikujtojë përfaqësuesit të autorizuar obligimet e tij ligjore dhe profesionale. Gjykata është dashur po ashtu t'i udhëzoj palët lidhur me veprimet procedurale në përgjigje ndaj punës së dobët të avokatit të tyre dhe obligimeve të tij profesionale.<sup>27</sup> Së fundmi, gjykata është dashur ta vlerësojë se a parasheh sjellja e avokatit dënim me gjobë ose ndonjë tjerë masë ligjore, ose, siç parashihet me LPK, ta njoftojë odën e avokatëve.<sup>28</sup> Një qasje më pro-aktive nga ana e gjykatës lidhur me menaxhim të lëndës do t'i ndihmonte këto palë që ta vlerësojnë kualitetin e përfaqësimit që ata po merrnin nga avokati i tyre, dhe po ashtu kishin mundur të minimizojnë ndikimin e tij negativ.

Siç është cekur më lartë, avokatët kanë për detyrë profesionale që t'i ofrojnë palëve të tyre ndihmë ligjore për të parandaluar vonesat ose keqpërdorimet e të drejtave

---

<sup>26</sup> Neni 10, LPK.

<sup>27</sup> Neni 11.2, LPK.

<sup>28</sup> Neni 10.2 dhe 88.2, LPK.

procedurale.<sup>29</sup> Përkundër këtij detyrimi, OSBE ka monitoruar raste kur sjellja e përfaqësuesit të autorizuar ka shkaktuar vonesë në procedurë.

Me 30 mars 2006, paditësi parashtroi një kërkesë për kompensim të dëmit pranë një gjykate të qarkut. Një seancë përgatitore ishte mbajtur me 14 nëntor 2008 ku ishte i pranishëm vetëm i padituri. Gjyqtari shtyu seancën për 12 dhjetor 2008, dhe më pas për 10 shkurt 2009 për shkak të mungesës së vazhdueshme si të paditësit ashtu edhe të përfaqësuesit të tij të autorizuar. Seanca u mbledh me 10 shkurt 2009, por për shkak se i pranishëm ishte vetëm përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit seanca u shty për 09 mars 2009. Pastaj gjyqtari e shtyu seancën e 09 marsit 2009 në përgjigje të një kërkesë të përfaqësuesit të paditësit i cili kishte konflikt në orar. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit dështoi të paraqitet në cilëndo nga katër datat e caktuar për seancë përgatitore, por dha arsyetim për mungesë vetëm për mungesën e katërt. Veç kësaj, përfaqësuesi i autorizuar nuk ka dërguar ndonjë praktikant që ta zëvendësojë atë në seancën përgatitore, një procedurë e paraparë me LPK.<sup>30</sup>

Dështimi i paarsyeshëm i përfaqësuesit të autorizuar për të marr pjesë në seancë gjyqësore është shkelje e obligimeve profesionale të përfaqësuesit ndaj klientit dhe ndaj gjykatës. Kërkesat e vazhdueshme për shtyrje, veçanërisht nëse kërkesat nuk bëhen me kohë apo pa justifikim adekuat mund të përbëjnë shkelje të detyrimeve profesionale dhe ligjore të përfaqësuesit, dhe përbëjnë shkelje të Ligjit mbi Avokatinë. Veç kësaj, korniza ligjore e Kosovës i jap pushtet gjykatës që ta rikujtojë përfaqësuesin e autorizuar për obligimet e tij profesionale, t'i shqiptojë dënim me gjobë ose masa tjera ligjore, ose ta njoftojë odën e avokatëve lidhur me sjelljen e tij: Është me rëndësi që gjykata të merr parasysh shfrytëzimin e këtyre masave ligjore kur paraqitet rasti. Në të kundërtën palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në sallë të gjykimit mund ta perceptojnë mosveprimin e gjykatës si pranim të heshtur të sjelljes së tillë.

Në përgjigje ndaj çështjeve të diskutuara më lartë, OSBE rekomandon siç vijon:

### **Për Avokatët Mbrojtës dhe Përfaqësuesit e Autorizuar**

- Ata që ofrojnë përfaqësim ligjor do të duhej të sillen me zell dhe me profesionalizëm kur promovojnë interesat e klientëve dhe mbrojnë të drejtat e klientëve. Ata do të duhej t'i menaxhojnë kalendaret e tyre të gjykimeve në atë mënyrë që të paraqiten me kohë, t'i shmangen kërkesave për shtyrje dhe të mos mungojnë pa dhënë arsyetim. Gjykatat do të duhej të njoftohen paraprakisht me arsyetime të qëndrueshme për shtyrje apo mungesa.

### **Për Gjykatën**

- Gjykatat do të duhej t'i menaxhojnë rastet në mënyrë pro-aktive, të sigurojnë që procedurat zhvillohen pa vonesa, dhe të marrin parasysh shqiptimin e dënimeve

<sup>29</sup> Neni 49, Kodi i Etikës Profesionale.

<sup>30</sup> Neni 90.4, LPK.

me gjobë ose masave tjera ligjore për të minimizuar përfaqësimin ligjor jo-efektiv.

#### **Për Institutin Gjyqësor të Kosovës**

- Instituti Gjyqësor i Kosovës do të duhet të vazhdojë trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi menaxhimin pro-aktiv të rasteve, përfshirë trajnimin se si të veprohet kur Avokatët Mbrojtës dhe Përfaqësuesit e Autorizuar janë jo-efektiv.

#### **Për Odën e Avokatëve të Kosovës**

- Oda e Avokatëve të Kosovës inkurajohet të merr parasysh trajnimin e anëtarëve të vet mbi obligimet e tyre profesionale dhe etike siç parashihen me legjislacion.